**AKT THEMELIMI**
**SHOQERIA "Studio " KORAL 23"SHPK**

Sot, më date 09.05.2024 une i nenshkruara:

- Paola Hida, atësia Shpetim amësia Teuta, shtetas Shqiptare, lindur në Librazhd dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga Bill Klitoni ; Nd. 1, Ap. 45; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 02.12.1996, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 039217708 dhe nr. personal J66209009M

Në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", kam vendosur të themeloje një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar **" Studio " KORAL 23"SHPK** (më poshtë referuar si *"Shoqëria"*), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi.

**NENI 1**

Emri i Shoqërisë është **" Studio " KORAL 23"SHPK**

**NENI 2**

Shoqeria do te kete Seline e saj në Rruga Bill Klitoni ; Nd. 1, Ap. 45; Njësia Administrative Nr. 5 Tirane.

Selia e shoqerise mund te transferohet.

**NENI 3**

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë e papercaktuar. Por kjo shoqeri mund te shperbehet edhe para mbarimit te ketij afati sipas rasteve te parashikuara ne statutin e kesaj shoqerie.

**NENI 4**
**OBJEKTI I SHOQËRISË ËSHTË SI VIJON:**

- Projektim arkitekturor per objekte banimi , objekte industriale – objekte turistike • Objekte sportive te mbuluara ose pjeserisht te mbuluara, qendra tregtare , objekte social kulturore , objekte kulti , objekte arsimore , objekte spitalore – treminale ne infrastructure , vepra arti ne infrastructure • Projektim Interier • Projektim pejsazhi, sistetmim siperfaqe te gjelberta lulishte e parqe
- .PROJEKTIM KONSTRUKTOR • Objekte civile , industrial – turistike prej murature dhe skelet beton arme deri ne 5 kate • Objekte civile , industrial e turistike mbi 5 kate – obejkte me skelet metalik • Objekte me shkalle te larte veshtiresie beton arme – metalike – troje dhe shpate me qendrushmeri te ulet • Vlersim I

kapacitetit mbajtes dhe perforcim mi strukturave mbajetese prej beton arme , murature – metalike • Objekte civile turistike prej druri

- c.PROJEKTIM INSTALOR • Projektim te instalimeve hidrosanitare • Projektim te instalimeve termoteknike – kondicionimi , si dhe te impjaneteve te prodhimit te energjis termike nga burime te rinovueshme • Projektim te sistemeve kundra zjarrit • Projektim te sistemeve te furnizimit me gaz • Projektim te sistemeve te monitorimit dhe automatizimit ne industri dhe ndertesa d. shkarkues te ujrave te teperta , vepra te marrjes se ujit nga rrezervuaret , vepra te marrjes se ujit nga lumenjt dhe marrja e ujit me puse • Vepra hidroteknike , kulla ekuilibri – porte pontile • Vepra naftesjelles , gazesjellese, vajesjellese
- .PROJEKTIM RRUGE HEKURUDHA • Rruge locale, rruge urbane dytesore , dhe rruge interurbane dytesore • Projektim rruge urbane kryesore dhe rruge interurbane kryesore • Aurostrada , aeroporte, helioporte – hidroporte • Hekurudha , degzim hekurudhe • Projektim urad he vepra arti te vogla deri ne 10m dhe mbi 10 m • Ura vadukte me hapesira te medha dhe ura te varura , ura me sisteme te pacaktuara statikisht dhe sisteme te tjera speciale • Ura metalike • Tunele rrugore dhe hekurudhore • Sinjalistike jo ndricuese ne rruge lokale , rruge urbane dytesore , rruge interurbane dytesore , sheshe e parkime • Sinjalistik jo ndricuese ne autostrada , rruge urbane kryesore dhe rruge interurbane kryesore dhe ne degezime me hekurudha • Sinjalistike jo ndricuese ne aeroporte dhe helioporte • Sinjalistike ndricese ne infrastrukture
- .MBIKQYRJE KOLAUDIM • Punime germimi ne toke , ndertime civile dhe industrial , rikonstruksione dhe mbirembajtje godinash civile, industrial, veshje fasade, rruge autostrada , ura , mbikalime hekurudhore , tunele , linja tranvain , metro , hekurudha me kavo , dhe pista aeroportuale , punime nentokesore , ura e vepra arti , diga te vogla deri ne 10m te larta , tunele hidrotkenike , ujesjelles , kanalizime , vepra kullimi e vaditje , vepra naftesjelles , naftesjelles e vajesjelles , ndertime detare dhe punime thellimi ne uje , punime dhe mbrojtje lumore , sisteme hidraulike dhe bonifikuese , punime te inxhinjeris se mejedisit , punime per prishjet e ndertimeve , impjante hidrotermosanitare dhe mirembajtja e tyre • Punime rifiniture te muratures dhe te lidhjes me to , rifinitura me materiale druri , plastike , metalike dhe xhami dhe rifinitura te natyres teknike ndertuese , impjanete te sinjalistikes ndricuese te trafikut , sinjalistika rrugore jo ndricuese , ndertime parafabrikat beton arme , struktura metalike, druri, punime strukturore speciale , shtresa dhe mbistruktura speciale , punime mbi shina dhe traversa , sisteme kundra zjarrit per infrastrukture
- .TE VECANTA • Vlersim pasurie • Projektim te sistemeve te zjarrit ne ndertesa civile , industrriale, tunele • Akt ekspertize qendrueshmeri obejktesh industrial e civile , ura etj. • Zbatim punimesh ne ndertime industrial, civile et Veprimtari ne fushen e tregetimit te mobiljeve te ndryshme dhe pajisjeve hidrosanitare. Import-Eksport te mallrave, mobiljeve dhe pajisjeve industriale te ndryshme. Tregetim i mobiljeve te zyres, mobilje per qendrat shendetesore, spitale, laboratore mjekesore si dhe grila, rrollera, perde etj,;
- Cdo aktivitet tjeter te nevojshem per realizimin e qellimit te Shoqerise.

**NENI 5**
**KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqerise " **Studio " KORAL 23"SHPK**
do te jete 100.000 (njeqind mije) leke i ndare ne 1 kuote si më poshtë vijon:

1. Paola Hida zotëron 1 kuotë, me vlerë 100% te kapitalit themeltar.

Ortaku mund të vendosi të rrise kapitalin e Shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Detyrimi i ortakut kundrejt Shoqërisë do të mbulohet vetëm me pjesën e kapitalit të paguar prej tij. Ortaku nuk do të ketë asnjë përgjegjësi tjetër për detyrime të tjera të Shoqërisë.
Kuotat e Ortakëve regjistrohen në librin e regjistrimit të kapitalit të Shoqërisë.

Kuotat mund të shtohen apo të reduktohen me vendim të Asamblesë së Ortakëve sipas Ligjit 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndyshuar.

Kapitali i Shoqërisë i kontribuar nga cdo ortak do të regjistrohet në librin e regjistrimit të kapitalit të Shoqërisë.

## NENI 6
## ORGANËT E SHOQËRISË

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës privatë dhe merr përsipër vetëm të drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore.

Organët drejtuese të Shoqërisë " **Studio " KORAL 23"SHPK**
shpk janë:
1- Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë, organi më i lartë vendimarrës.
2- Administratori i Shoqërisë.

Kompetëncat e Asamblesë së Ortakëve si dhe të Administratorit të Shoqërisë janë të parashikuara në statutin e Shoqërisë.

## NENI 7
## LIGJI I APLIKUESHEM

Veprimtarinë e saj, Shoqëria do ta zhvillojë në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

Të drejtat dhe detyrat e Asamblesë së Ortakëve, organizimi i Shoqërisë, marrëdhëniet me përsona fizikë dhe/ose juridikë, vendas dhe /ose të huaj, shprehen në statut që bashkë me aktin e themelimit janë dhe dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e marrëdhënieve në këtë.

## NENI 8
## ADMINISTRATORI

Administratori i Shoqërisë " **Studio " KORAL 23"SHPK**
" shpk do të jetë Znj. Paola Hida per nje afat 5 vjecar.

Administratori emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve.

**NENI 9**
**KONFEDIANCILITETI**

Ortaket e shoqerise bien dakord të mbrojnë dhe të mos zbulojnë informacione që konsiderohen konfidenciale dhe të cilave përmbajtja e tyre nuk lejohet t'i bëhet publike palëve të treta. Do të konsiderohet informacion konfidencial për të gjitha aktet dhe dokumentet që janë përcaktuar si të tilla nga Administratori i Kompanisë.

**NENI 10**
**TE PUNESUARIT**

Marrëdheniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në Republikën e shqipërisë. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të rrespektojnë Statutin e kësaj Shoqërie dhe rregullat e brëndshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj Shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

**NENI 11**
**LIKUIDIMI**

Në rast se Shoqëria do tëe mbyllë aktivitetin e saj për cdo lloj arsye, Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë, përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tëpër likuidatorë dhe përgatit të gjitha dokumentët e nëvojshme për c'regjistrimin e saj nga Qëndra Kombëtare e Biznësit.

**NENI 12**
**AUDITIMI**

Kontrolli mbi veprimtarinë e Shoqërisë si dhe gjithë aktivitëtin e Shoqërisë i besohet një ekspërti ose revizori kontabël. Ky ekspërt do të emërohet dhe qëndrojë në detyrë sipas parashikimve që bën ligji për ekspërtët dhe mund të rizgjidhet. Asambleja e Ortakëve cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të vecanta ligjore.

**NENI 13**
**VITI FINANCIAR**

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit. Administratori merr masat me qëllim hartimin e bilanceve, rezultatëve ekonomike të fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit të cështjeve të mësipërme si dhe shlyerjen e detyrimeve, të ardhurat e tjera do ti kalojnë ortakëve të Shoqërisë.

**NENI 14**
**PERRFUNDIMI**

Kjo Marrëveshje do të fillojë në datën e hyrjes në fuqi dhe përfundimi i saj është i pakufizuar.

**NENI 15**
**DISPOZITA PERFUNDIMTARE**

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përsa është shprehur në këtë Akt Themelimi, i referohemi ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe ligjit nr.9723. datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Biznësit".

**ORTAKU I SHOQËRISË**

Paola Hida